



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës

01.Nr. 670/01-644 /18
Kaçanik, 01.03.2018

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr. 400/01-1823/15 si dhe nenit 14, 15 të Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për Ndarjen e Bursave dhe Caktimin Kriterëve për Vitin Akademik 2017-2018

1. Me këtë Vendim caktohen kushtet për aplikim, kriteret e përzgjedhjes, kohëzgjatja e realizimit të bursave, lartësia dhe numri i përfituesve të bursave.
- 2.. Për vitin akademik 2017-2018, Komuna e Kaçanikut ndan 50 bursa për student të studimeve themelore universitare, në shumën 40 € në muaj (për 10 muaj).
3. Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kriterë:
 - 3.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
 - 3.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike,
 - 3.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
 - 3.4 të jenë student të vitit të dytë e më lartë,
 - 3.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
 - 3.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Arkitekturë dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor).
4. Nga një familje mund të përfitoj vetëm një student, ndërsa përfitues do të jetë ai student që ka notën mesatare më të lartë.
5. Studentët të cilët i plotësojnë kriteret nga pika (III) e këtij vendimi, gjatë aplikimit duhet t'i paraqesin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Rregulloren Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtyre kritereve:

6.1 Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 5,

6.2 Studentët të cilët i takojnë kategorive të dala nga lufta (fëmijët e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve të luftës), u shtohen 15 pikë,

6.3 Studentët me gjendje të rëndë ekonomike, pa prind dhe studentë me aftësi të kufizuara, u shtohen 15 pikë dhe

6.4 Dy e më shumë studentë nga një familje, u shtohen 10 pikë.

7. Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

8 . Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

9. Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Arkiva.

Kryetari i Komunës;

z.Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13.17 të Ligjit nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kërkesës së Shoqatës -Asociacionit **“Loti dhe Shpresa”** me nr. 104/02-6029 e dt. 27.02.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Neni 1.

Me anë të këtij vendimi i lejohej Shoqatës -Asociacionit **“Loti dhe Shpresa”** që të furnizohet me derivate- naftë deri në 200 litra, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të planifikuara - të specifikuara sipas kërkesës së bashkëngjitur të këtij vendimi, të cilat do të zhvillohen më datë 11.03.2018

Neni 2.

Për sasinë e lejuar sipas pikes 1. të këtij vendimi **“Shoqata –Asociacioni “Loti dhe Shpresa”** mund të furnizohet me derivate të naftës tek operatori ekonomik, i cili ka kontratë të arritur me K.Kaçanik për furnizim me derivate **“Bubeari Petrol”** dhe pas furnizimit, obligohet që fletdërgesat në ngarkim ti dorezoj pranë të Drejtorisë së Administratës Komunale (Zyra e Pranimit të mallrave - faturave) –Kaçanik.

Neni 3.

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, dhe **“Shoqata – Asociacioni “Loti dhe Shpresa”**

Bashkëngjitur këtij vendimi:

- Kërkesa e Shoqatës -Asociacionit **“Loti dhe Shpresa”**



KOMUNA E KAÇANIKUT

Besim Ilazi, Kryetar i komunës

PËR: z.Besim Ilazi, Kryetar I Komunës Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK

27.02-2018 KACANIK

01 104/02-6029-1.

KËRKESE

Shoqata „Loti dhe Shpresa” kërkon nga Kryetari I Komunës mbështetje me derivate të naftës për zhvillimine aktiviteteve rehabilitues para fillimit të përvjetorit të vrasjeve dhe masakrave të familjeve të vrarë, të të zhdukurve, dëshmorëve, martirëve, që do të realizohen gjatë muajve mars, prill, maj dhe qershor 2018.

Shpenzimet tjera për projektin „Dhembja te dhembja”, ku përfshihen mëngjesi, dreka, sigurimi I autobusit, salla e takimit, lule për homazhe etj. janë nga kryqi I kuq ndërkombëtar dhe britanez.

Vizita sipas projektit bëhet në 6 komuna të Kosovës (Gjakovë, Krushë e madhe, Skenderaj, Klinë, Therandë dhe Fushë Kososovë), në bashkëpunim me shoqatën si motër nga Ferizaji.

Në këtë aktivitet janë të caktuara 42 familjar të këtyre kategorive, kurse në Gjakovë na presin 24 familjarë të këtyre kategorie

Me respekt

Kaçanik

27.02.2018

Sevdije Frangu, Kordinatore e

Asociacionit „Loti dhe Shpresa” Kaçanik



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 400/01-1823/18 /18
Kaçanik, 01.03.2018

Në bazë të nenit 13, nenit 17 (r) dhe nenit 58 (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 si dhe Vendimit të Kuvendit 01.Nr.400/01-1823/18, të datës 24.01.2018, Kryetari i Komunës, merr këtë :

VENDIM

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 300.00 € Qendrës Kulturore "Kaçaniku", për aktivitetet e Ditës së Pavarsisë.
2. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor-Shërbime Kulturore, përkatësisht nga kategoria buxhetore e Subvencioneve dhe Transfereve.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.
5. Me këtë Vendim njoftohen: Qendra Kulturore "Kaçaniku", Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Arkiva.

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 104/02-6770/18
Kaçanik; 05.03.2018

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Rregullores 01 Nr.05-16-39427/16 e dt.21.12.2016 dhe Rekomandimit të Komisionit Komunal për ndarjen e Subvencioneve i dt.01.03.2018, Kryetari i Komunës bazuar në prioritetet dhe mundësitë buxhetore, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË OVL-UÇK-së

1. Me këtë vendim lejohet ndarja e mjeteve financiare nga Buxheti i Komunës për vitin 2018, në shumë prej **3,000.00 €**, për mbulimin e shpenzimeve të operimit për vitin 2018.
2. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij vendimi, do të realizohen në 3 (tre) këste të barabarta nga kategoria e Subvencioneve dhe transfereve të Programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit 16028 dhe do të transferohen në llogarinë bankare të OVL e UÇK –Kaçanik me nr. 1703-0016-0000-5511.
3. OVL e UÇK është e obliguar që shuma e mjeteve siq është paraparë në pikën 1. të këtij vendimi të shfrytëzohet për këtë qëllim dhe ta dëshmojë me fatura apo raporte të vlefshme të parapara me nenin 23. të Rregullores 01 Nr.05-16-39427/16.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Me vendim njoftohen:

1. OVL e UÇK –Kaçanik
2. Zyra e Kryetarit
3. Drejtoria e Financave dhe
4. Arkivi.

Besim Ilazi,
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01-Nr. 106/02-8294/18
Kaçanik, 14.03.2018

Në mbështetje të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 4 pika 3 të Ligjit për Teatrot nr. 04.L- 106, Rregullores nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, Kryetari i Komunës, bënë këtë;

PROPOZIM -VENDIM
Për iniciimin e themelimit të teatrit të qytetit

1. Inicohet procedura për themelimin e teatrit të qytetit si institucion me status publik.
2. Procedurat e themelimit të teatrit do të zhvillohen sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren nr. 04/2015 (MKRS) për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve, përkatësisht pas vlerësimit profesional të Komisionit të veçantë të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.
5. Me këtë Vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillimit dhe Arkiva.



Kryetari i Komunës;
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Nr. 01-600/01-9103 /2018
Kaçanik, 21.03.2018

Bazuar në Ligjin nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr.05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ligjit Nr.04/L-194 Për MFPP, si dhe të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE

1. Me këtë vendim lejohen mjetet finaciare nga buxheti i Komunës për vitin 2018, nën-programi – Shërbimet e shëndetësisë primare (74700) , në shumë prej **8,394.83 €** për financimin e projektit "Ndërtimi dhe renovimi i objektit QMF-së K.Vjeter"
2. Mjete buxhetore nga pika 1.e këtij vendimit ,do të sigurohen nga nën-programi buxhetor Shërbimet e shëndetësisë primare (74700) , përkatësisht nga projekti i investimeve kapitale " Renovimi I objekteve dhe infrastrukturës shëndetësore" (KP 46820).
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë,Financave dhe Zhvillimit.
4. Me këtë Vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa e Zhvillim dhe Arkivi i Komunës.

Kryetari i Komunës
Besim Hazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-9097/18
Kaçanik, 21.03.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Vendimit të Kuvendit 01.Nr.400/01-1823/18, të datës 24.01.2018, Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Thirrjes Publike në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 01.Nr.104/02-4679/2018 si dhe rekomandimin e komisionit për ndarjen e subvencioneve, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM Për ndarjen e subvencioneve

1. Lejohen mjetet financiare për subvencionimin në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2018, si në vijim:

1.1. SHKA "Tingujt e Vendlindjes" -----	2,300.00 €;
1.2. SHKA "Gryka e Kaçanikut" -----	700.00 €;
1.3. KVRL -----	1,200.00 €;
1.4. KF "Lepenci" -----	17,800.00 €;
1.5. KM "Kaçaniku" -----	1,000.00 €;
1.6. KSH "Lepenci" -----	800.00 €;
1.7. KV "Kaçaniku" -----	2,000.00 €;
1.8. SHP "Kulturës Fizike" -----	500.00 €;
1.9. KH "Lepenci" -----	3,500.00 €;
1.10. SHB Alpiniste "Kaçaniku2015" -----	700.00 €;
1.11. KB "Kaçaniku" -----	3,500.00 €.
1.12. Qendra Kulturore "Kaçaniku" -----	8,500.00 €

2. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij Vendimi, sigurohen nga programi buxhetor - Shërbime Kulturore, përkatësisht nga kategoria buxhetore e Subvencioneve dhe Transfereve.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik.

5. Me këtë Vendim njoftohen: përfituesit e subvencioneve, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Arkiva.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 104/02-954/18

Kaçanik, 23.03.2018

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Neni 8 i Rregullores Nr. 01-104/02-30543/17 për Vendorsjen e Tatimit në Pronë në Territorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2018, të datës 15/09/2017; Neni 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2011 për Ankesat e Tatimit në Pronën e Paluajtshme; nenit 73 të Statutit të komunës së Kaçanikut, i datës 25.09.2008; Kryetari i komunës së Kaçanikut, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E BORDIT TË ANKESAVE PËR TATIMIN NË PRONË

1. Me këtë vendim Formohet Bordi i pavarur komunal për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpagueseve lidhur me tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018.
2. Bordi formohet në përbërje prej tre anëtarësh, dhe atë:
 - 2.1. Fadil Guri, kryesues;
 - 2.2. Arlinda Zeqiri, anëtare;
 - 2.3. Mentor Shehu, anëtar.
3. Mandati i këtij bordi sipas këtij vendimi përfundon më 31.12.2018.
4. Shpenzimet administrative të krijuar lidhur me punën e këtij bordi do t'i bartë Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari të Komunës.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen:

1. Anëtarët e Bordit;
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit;
3. Arkivi i komunës.



Kryetari i Komunës
Z. Besim Ilazi